



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2023:271245

Datë: 28.06.2024

Numri i dokumentit: 05873874

KPPP.nr.2098/23

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, gjyqtari Arnis Dumani, në çështjen përbarimore të kreditorit Komuna e Prishtinës, me seli në Prishtinë rr. "UÇK" nr.2, kundër debitorit "Kastrati Pharm" SH.P.K., me numër të regjistrimit të biznesit 71338053, me seli në Prishtinë, rr. "Enver Maloku" nr. 116, duke vendosur lidhur me prapësimin e debitorit, të ushtruar kundër Urdhrit Përbarimor P.nr.438/23 të datës 17.08.2023, të Përbaruesit Privat Destan Bujupaj me seli në Prishtinë, jashtë seancës me datës 28.06.2024, merr këtë:

A K T V E N D I M

PRANOHET si i bazuar prapësimi i debitorit "Kastrati Pharm" Sh.P.K., ashtu që Urdhri Përbarimor P.nr.438/23 i datës 17.08.2023, i lejuar nga Përbaruesi Privat Destan Bujupaj, ANULOHET.

A r s y e t i m

Përbaruesi Privat, duke vepruar sipas propozimit të kreditorit Komuna e Prishtinës, ka lëshuar Urdhrit Përbarimor P.nr.438/23 të datës 17.08.2023 me të cilin e ka lejuar përbarimin në bazë të dokumentit të besueshëm, Faturës Nr.201912707 të datës 19.12.2022 me të cilin ka detyruar debitorin që në afat prej 7 ditësh nga dita e pranimit të këtij urdhri kreditorit t'ia paguaj borxhin në shumën prej 1,500.00€ si dhe shpenzimet tjera të procedurës nën kërcënimin e përbarimit të dhunshëm, këtë përmes bllokimit të llogarive bankare të debitorit, sekuestrimit të letrave me vlerë, sekuestrimin dhe vlerësimin të paluajtshmërive si dhe përbarimin për pjesën e pasurisë së debitorit në shoqëri.

Kundër urdhrit për lejimin e përbarimit, brenda afatit ligjor debitori ka ushtruar prapësim me të cilin ka kundërshtuar në tërësi urdhrit përbarimor me arsyetimin se debitori "Kastrati Pharm" SH.P.K., që nga viti 2016 ka të regjistruar biznesin në Komunën e Pejës aty ku edhe sot

vepron, andaj nuk është e mundur që Komuna e Prishtinës të kërkojë pagesën e taksës kur biznesi vepron në një komunë tjetër, po ashtu ka shtuar se debitori që nga viti 2020 nuk ka pasur asnjë qarkullim, kjo vërteton se ky biznes tash e tre vite nuk është funksional. Andaj duke konsideruar që kjo faturë është lëshuar në kundërshtim me Ligjin për Financat e Pushtetit Lokal si e tillë nuk mund të konsiderohet si dokument i vlefshëm. Andaj, i ka propozuar gjykatës që të pranohet si i bazuar prapësimi i debitorit i ushtruar ndaj Urdhrit Përmbarrimor P.nr.438/23 të datës 17.08.2023 si dhe të anulohen të gjitha veprimet e ndërmarra nga përmbarruesi.

Kreditori brenda afatit ligjor ka ushtruar përgjigje në prapësimin e debitorit ku ka theksuar se asnjëra nga kundërshtimet e debitorit të paraqitura në prapësim nuk përbën bazë për kundërshtin në përputhje me nenin 71 të Ligjit për Procedurën Përmbarrimore. Gjykatës i ka propozuar që prapësimin e debitorit ta refuzoj si të pabazuar dhe të lë në fuqi Urdhrin Përmbarrimor P.nr.438/23 të datës 17.08.2023.

Gjykata pas shqyrtimit të pretendimeve të debitorit të paraqitura në prapësim, përgjigjes në prapësim të kreditorit, si dhe pas shqyrtimit dhe vlerësimit të provave që gjenden në shkresat e lëndës, duke iu referuar dispozitave të nenit 69 dhe 71 të Ligji Nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbarrimore, (tutje: “LPP”) gjeti se prapësimi i debitorit është i bazuar dhe vendosi sikurse në dispozitiv të këtij aktvendimi, për këto arsye:

Gjykata vlerëson se organi përmbarrues ka lejuar përmbarrimin bazuar në nenin 21 të LPP-së i cili përcakton se: *“Organi përmbarrues e cakton, përkatësisht e zbaton përmbarrimin vetëm në bazë të dokumentit përmbarrues (titulus executionis) dhe dokumentit të besueshëm, po qe se me këtë ligj nuk është parashikuar diçka tjetër”*.

Neni 29, paragrafi 1 i LPP-së, përcakton se: *“Përmbarrimi me qëllim të realizimit të kërkesës në të holla caktohet edhe në bazë të dokumentit të besueshëm”*, ndërsa pika 1.3 e të njëjtit nen përcakton faturën si dokument i besueshëm sipas të cilës mund të caktohet përmbarrimi për realizimin e kërkesës në të holla. Tutje, me paragrafin 3 të të njëjtit nen parashihet se: *“Dokumenti i besueshëm është i përshtatshëm për përmbarrim po qe se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, lloji, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit monetar”*. Në anë tjetër, sipas nenit 37 të LPP-së: *“Kur propozimi për përmbarrim paraqitet në bazë të dokumentit të besueshëm, mjafton që propozimit t’i bashkëngjitet dokumenti i tillë origjinal apo kopja e tij e vërtetuar sipas ligjit”*.

Gjykata duke u bazuar në të lartcekurat gjeti se Urdhri Përmbarimor P.nr.438/23 i datës 17.08.2023, i lejuar nga Përmbaruesi Privat Destan Bujupaj, bazohet në faturën Nr.201912707 të datës 19.12.2022, e cila nuk i plotëson kushtet për të qenë dokument i besueshëm sipas nenit 29.3 të LPP-së, për faktin se fatura e lartcekur, nuk përmban nënshkrimin apo vulën e debitorit tek pranuesi i faturës, e rrjedhimisht rezulton se e njëjta nuk është pranuar me rregull nga debitori. Ndërsa, në anën tjetër, kreditori nuk ka arritur të dëshmoj se në ndonjë mënyrë tjetër të përshtatshme ia ka dorëzuar debitorit, ndërsa ky i fundit ka pranuar faturën në fjalë dhe se është pajtuar më përmbajtjen dhe lartësinë e të njëjtës. Rrjedhimisht, fatura si e tillë rezulton të jetë lëshuar në mënyrë të njëanshme nga kreditori, andaj edhe nuk i plotëson kushtet për të qenë dokument i besueshëm.

Gjykata ka vlerësuar edhe pretendimet e tjera të debitorit sa i përket ushtrimit të veprimtarisë së debitorit në rajonin e Komunës së Pejës, mirëpo gjeti se të njëjtat nuk kanë ndikim në vendosjen ndryshe lidhur me këtë çështje përmbarimore, ndërsa në mbështetje të nenit 73 të LPP-së, lidhur me prapësimin e debitorit ka vendosur jashtë seancës gjyqësore.

Nga sa më sipër, bazuar në nenin 73, paragrafi 3 të LPP-së, nenin 13, paragrafi 1, pika 1.2, dhe Ligjit nr. 08/L-015 për Gjykatën Komerciale, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

## GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Parë - Departamenti për Çështje Ekonomike

KPPP.nr.2098/23, datë 28.06.2024

Gjyqtari

Arnis Dumani

**KËSHILLA JURIDIKE:** Kundër këtij aktvendimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej shtatë (7) ditëve, nga dita e pranimit të aktvendimit, në Dhomat e Shkallës së Dytë, në Gjykatën Komerciale të Kosovës, përmes Dhomave të Shkallës së Parë të kësaj Gjykate.